



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë  
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije  
Ministry of Education, Science and Technology

# Treguesit dhe të dhënat statistikore në arsim

2004/05, 05/06, 06/07



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government


Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë  
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije  
Ministri of Education, Science and Technology

# TREGUESIT DHE TË DHËNAT STATISTIKORE NË ARSIM 2004/05, 05/06, 06/07

Hartuar nga / pripremljeno od / prepared by  
Azem Azemi, Zyra për planifikim /planning office / kancelarija za planiranje  
Enver Mekolli, SMIA /EMIS / SVIO  
Shqipe Bruqi, SMIA /EMIS / SVIO  
Hazbije Lahu, SMIA /EMIS / SVIO

Përkrahur nga / supported by / podržano od strane  
UNICEF,  
Zyra në Kosovë / Kosovo Office / Kancelaria na Kosovo





ARSIMI PARAUNIVERSITAR  
TREGUES DHE TË DHËNA STATISTIKORE  
VITET SHKOLLORE:  
2004/05; 05/06; 06/07





## PËRMBAJTJA

<b>HYRJE .....</b>	<b>6</b>
Faza emergjente .....	6
Faza zhvillimore .....	6
Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim .....	7
Qëllim i raportit statistikor .....	9
I. Nxënës/Fëmijë .....	10
II. Personel arsimor .....	10
III. Shkolla/Objekte .....	10
<b>I. NXËNËS .....</b>	<b>11</b>
1. Numri i nxënësve sipas niveleve .....	11
2. Numri i nxënësve sipas gjinisë .....	14
3. Numri i nxënësve sipas përkatësisë etnike .....	15
3. Numri i nxënësve/ fëmijëve në arsimin special .....	15
Klasat e bashkangjitura .....	17
6. Suksesi i nxënësve .....	18
Suksesi sipas vlerësimit me notë .....	18
Viti shkollor 2003/2004 .....	18
Viti shkollor 2004/2005 .....	18
Viti shkollor 2005/2006 .....	19
Rezultatet e Testit të arritshmërisë pas përfundimit të klasës së 9-të .....	20
Rezultatet e provimit të matures .....	21
6. Braktisja e shkollës nga nxënësit .....	22
5. Realizimi i planit mësimor .....	26
<b>II. PERSONELI ARSIMOR .....</b>	<b>30</b>
1. Numri i personelit arsimor .....	30
2. Struktura e personelit arsimor .....	32
3. Numri i mësimdhënësve sipas niveleve .....	33
4. Struktura kualifikuese e mësimdhënësve .....	34
<b>II. SHKOLLA/OBJEKTE .....</b>	<b>36</b>

## HYRJE

Arsimi parauniversitar në Kosovën e pasluftës është ballafaquar me shumë sfida, dhe si i tillë, vlerësohet të ketë qenë mjaft dinamik krahasuar me zhvillimet politike, ekonomike e shoqërore të Kosovës në përgjithësi. Gjatë periudhës 1999 – 2007 zhvillimet kryesore nëpër të cilat ka kaluar arsimi parauniversitar kanë njohur dy faza kryesore: faza emergjente dhe ajo zhvillimore.

### *Faza emergjente*

Faza emergjente përfshinë periudhën prej gjysmës së dytë të vitit 1999 dhe zgjatë deri në fund të vitit 2002. Gjatë kësaj faze qëllim primar ishte riaktivizimi i sistemit të arsimit në Kosovë, që karakterizohej kryesisht me sanimin e pasojave të luftës sidomos në ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës shkollore. Krahas përpjekjeve të mëdha për akomodimin e të gjithë nxënësve në objekte shkollore gjatë kësaj faze janë bërë edhe përgatitjet për fillimin e reformave rrënjësore në sistemin e arsimit në Kosovë kryesisht në hartimin, aprovimin dhe implementimin e ligjeve dhe dokumenteve siç janë:

- Hartimi i Kornizës së Kurrikulit të Ri të Kosovës;
- Hartimi dhe implementimi i Strukturës së Re të Sistemit të Arsimit në Kosovë 5-4-3/4 ;
- Hartimi dhe miratimi i ligjit për Arsimin Fillor dhe të Mesëm;
- Hartimi i ligjit për Arsimin e Lartë;
- Përgatitja dhe zbatimi i një numër të madh i udhëzimeve administrative, rregulloreve dhe akteve tjera nën ligjore;
- Hartimi i Strategjisë së zhvillimit të Arsimit të Kosovës 2002 – 2007.

### *Faza zhvillimore*

Faza zhvillimore e cila përfshinë periudhën prej vitit 2003 e këndeje konsiderohet si fazë e zhvillimit dhe implementimit të reformave në arsim.

Struktura e re arsimore po realizohet në të gjitha nivelet e shkollimit. Përpjeke të vazhdueshme janë duke u bërë që procesi i reformave arsimore të realizohen sipas dinamikës së paraparë në Planin e Zhvillimit Strategjik të Arsimit të Kosovës 2002-2007.

Planet e programet dhe trajnimi i mësimdhënësve në arsimin e përgjithshëm, profesional dhe në arsimin joformal po zhvillohen në mbështetje të reformave bashkëkohore programore dhe me një qasje të re metodologjike.

Krahas programeve të reja mësimore dhe trajnimit të mësimdhënësve është duke u zhvilluar një proces dinamik i hartimit dhe përgatitjes së teksteve shkollore. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në këtë drejtim, ka përgatitur bazën ligjore, përkatësisht Udhëzimin Administrativ Nr. 26/2003, i cili në masë të madhe e ka ndihmuar zhvillimin e këtij procesi. Me këtë udhëzim administrativ për herë të parë është hapur rruga e botimit të teksteve shkollore alternative dhe ka ndikuar në shmangien e monopolit ekzistues në këtë fushë shumë të rëndësishme arsimore që do të thotë se të gjitha shtëpitë botuese, të cilat i plotësojnë kushtet, kanë mundësi të barabarta konkurrimi. Konkurrenca e shtëpive botuese ka krijuar një garë pozitive e cila paraqet bazë të mirë për sigurimin e cilësisë së teksteve shkollore. Botimi i teksteve shkollore e ka ndjekur në hap zhvillimin e programeve sipas klasave, prandaj me rrumbullakimin e ciklit të pro-



grameve, është finalizuar edhe cikli i teksteve shkollore për të gjitha klasat dhe nivelet e arsimit parauniversitar.

Suksesi i nxënësve dhe vlerësimet e rezultateve të Testit kombëtar për vitet shkollore 2003/2004, 2004 /2005 dhe 2005/2006 tregojnë për një oscilim të vogël të suksesit krahas ngritjes së nivelit të kërkesave në Testin kombëtar. Kjo dëshmon orientimin tonë strategjik drejt një qasjeje të re për zhvillimin e reformave në arsim. Kjo qasje mbështetet në standardet e përmbajtjes dhe në standardet të arritshmërisë të cilat janë të krahasueshme dhe përkojnë me standardet arsimore evropiane.

Në lëmin e infrastrukturës ligjore, pothuaj është mbuluar çdo veprimtari arsimore . Në parlamentin e Kosovës deri më tani janë miratuar këto ligje:

- Ligji për Arsimin Fillor dhe të Mesëm ( Rregullorja e UNMK-ut Nr. 2002/19 e datës 31.10. 2002 );
- Ligji për Arsimin e Lartë ( Rregullorja e UNMK-ut Nr. 2003/14 e datës 12 .5. 2003);
- Ligji për Inspeksionin e Arsimit ( Rregullorja e UNMK-ut Nr. 2004/55 e datës 17.12. 2004);
- Ligji për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore (Rregullorja e UNMK-ut Nr. 2005/8 e datës 23 .2. 2005);
- Ligji për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve ( Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/43 e datës 7.9. 2005);
- Ligji për Edukimin Parashkollor (Rregullorja e UNMK-ut 2006/11 e datës 6.3. 2006);
- Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/24 e datës 25.4. 2006);
- Ligji për botimin e teksteve shkollore dhe mjeteve mësimore.

Në procedurë parlamentare është Ligji për Provimin Përfundimtar dhe të Maturës që ka kaluar në Parlament dhe pritet miratimi.

Përpos ligjeve të përmendura, gjatë kësaj periudhe, janë nxjerr mbi 350 udhëzime administrative. Infrastruktura shkollore si dhe pajisja me mjete mësimore është duke u përmirësuar gradualisht, ndonëse lë për t'u dëshiruar edhe shumë.

Nga e gjithë kjo që u tha më lartë mund të përfundojmë se gjendja në arsimin kosovar nga viti në vit është duke shënuar rezultate të mira zhvillimi në të gjitha drejtimet.

## **Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim**

Në mënyrë që të organizohet puna e mirëfilltë në lëmin e arsimit në Kosovë, Banka Botërore ka iniciuar dhe ndihmuar themelimin e Sistemi të Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA), i cili ka për qëllim grumbullimin, përpunimin, raportimin, monitorimin, vlerësimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore dhe treguesve relevant të arsimit. SMIA sot menaxhohet dhe koordinohet nga MASHT-i dhe vazhdon të jetë fushë e cila duhet të përmirësohet në të ardhmen.

Përkundër arritjeve në këtë lëmi, ekzistojnë vështirësitë me të cilat ballafaqohet ky sistem.

Vështirësitë që e pengojnë funksionimin e plotë e të tërësishëm të këtij sistemi janë:





- Mungesa e të dhënave të sakta për shkak të mos regjistrimit të popullsisë që nga viti 1981;
- Operimi me të dhëna statistikore të pamjaftueshëm dhe tregues jo plotësisht të sakët;
- Të dhënat dhe treguesit e prodhuar nga SMIA nuk përdoren sa duhet si mjet për të ndihmuar monitorimin dhe vlerësimin e aspekteve të ndryshme të arsimit prandaj edhe nuk merret sa duhet parasysh gjatë proceseve të planifikimit, hartimit të politikave të arsimit dhe vendimmarrjes nga nivelet e ndryshme të arsimit.
- Mungesa e të kuptuarit të peshës dhe rëndësisë së Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim nga përgjegjësit e të gjitha niveleve;

Banka Botërore ka vazhduar të ndihmoj përpjekjet e MASHT, në veçanti Njësinë e Statistikave, e cila vepron në kuadër të MASHT-it, me zhvillimin e programit Infogather - Program për Menaxhimin e Informatave në Arsim, por janë paraqitur probleme që kanë ndikuar që ky program të mos i realizoi në tërësi objektivat e parapara. Ndër vështërsitë që e ndoqën zhvillimin dhe implementimin e këtij programi do të veçonim:

- Interesimi i pamjaftueshëm i bashkëpunimit të departamenteve dhe sektorëve të MASHT-it që të ndihmojnë dizajnimin e një programi të tillë i cili siguron të dhëna statistikore dhe tregues sasiorë e cilësorë të domosdoshëm e tejet të vlefshëm për planifikimin dhe zhvillimin e politikave arsimore të një vendi;
- Bashkëpunimi i pamjaftueshëm i shkollave dhe drejtorive komunale me qendrën për realizimin e programit;
- Të dhënat e marra nga shkollat përkatësisht drejtoritë komunale në shumë raste nuk kanë mund të përdoren, sepse kanë qenë të pasakta dhe nuk kanë përkuar me realitetin në shkolla;
- Pajisjet e pamjaftueshme dhe teknologjia informative e vjetruar dhe jo e mirëmbajtur;
- Zhvilluesit e programit në nivel shkollash dhe në nivel komunal nuk kanë qenë sa duhet të trajnuar, as në aspektin e përdorimit të teknologjisë, as në aspektin profesional të zhvillimit dhe implementimit të këtij programi, në futjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore, nxjerrjen e treguesve arsimor dhe hartimin e raporteve për nivele dhe fusha përkatëse arsimore;
- Mosgatishmëria e shkollave të komunitetit serb që të bashkëpunojë me MASHT-in për implementim të suksesshëm të këtij programi.

Nga viti shkollor 2004/2005 e këndej mbledhja dhe përpunimi i të dhënave statistikore është bërë në programin EXCEL, ndërsa bartja e tyre nga qendrat komunale, aty ku ka pas mundësi, është bërë përmes CD-ve, flesh-memorieve, internetit kurse në disa komuna kjo bartje është bërë në letër.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë ka vazhduar të bashkëpunojë me UNICEF me qëllim të funksionalizimit e avancimit të SMIA-së, në kuadër të programit softverik DevInfo, i cili është angazhuar për grumbullimin, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore, nxjerrjen e treguesve arsimorë, prezantimin dhe shpërndarjen e të njëjtave për periudhën 2004-2007. Dev-Info është aplikacion që mundëson ruajtjen, organizimin, paraqitjen dhe shpërndarjen e të



dhënave. Sot, në nivelin ndërkombëtar DevInfo përdoret për monitorim dhe raportim lidhur me Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit, por mund të adaptohet sipas kërkesave të shfrytëzuesit në nivel kombëtarë dhe nivele më të ulëta. Programi është i lehtë për të punuar dhe përbëhet prej dy moduleve: moduli për shfrytëzuesit (me numër të palimituar shfrytëzuesish) dhe moduli administrativ, i cili mundëson disajnimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave. DevInfo mundëson krijimin e tabelave, grafikoneve apo hartave në mënyrë shumë të lehtë. DevInfo është poashtu aplikacion për desktop dhe ka mundësinë e përdorimit përmes rrjetit të internetit. DevInfo nuk tenton t'i zëvendësojë bazat ekzistuese të të dhënave por qëllimi i këtij aplikacioni është që të dhënat ekzistuese t'i konsolidojë në bazë të të dhënave të cilat do të shpërndaheshin dhe kuptoheshin më lehtë në nivele të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.

## Qëllim i raportit statistikor

Ky raport ka për qëllim të paraqes treguesit dhe të dhënat statistikore për vitet shkollore 2004/2005; 2005/2006 dhe 2006/2007 të cilat janë të mbledhura, të sistemuara dhe të përpunuara në kuadër të programit softverik DevInfo. Natyra e këtij raporti është përshkruese dhe jo analitike dhe si i tillë paraqet hapin e parë drejt krijimit të bazës së të dhënave, të cilat do të përcillen në vitet e ardhshme dhe kështu mundësohet analizë e thellë e dukurive të dala nga kjo fushë. Pengesat me të cilat ballafaqohemi qëndrojnë në faktin se të dhënat e mbledhura dhe treguesit e nxjerrë nga këto të dhëna statistikore nuk janë krejtësisht të plotë dhe as të saktë. Në këtë drejtim mjafton vetëm një shembull siç është mungesa e të dhënave për arsimin e komunitetit serb. Edhe pse, përpjekjet e MASH-it për sigurimin e këtyre të dhënave kanë qenë të mëdha, nuk është hasur në gatishmëri për bashkëpunim nga shkollat, përkatësisht drejtoritë e këtij komuniteti. Mirëpo, në rastet kur shërbehemi me treguesit arsimorë të komunitetit serb, ne kemi marrë për bazë të dhënat e mbledhura e të përpunuara nga zyrtari i njësisë për komunitete në MASHT<sup>1</sup> të viti shkollor 2002/ 2003.<sup>2</sup>

Nga programi DevInfo është hartuar ky raport përmbledhës për vitet shkollore 2004/05, 05/06, 06/07 si dhe DevInfo CD-ja e cila përbëhet nga të dhënat e mbledhura statistikore për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

Të gjithë treguesit janë paraqitur përmes tabelave, grafikëve dhe hartave si dhe përshkrimit tekstual të tyre. Shfrytëzuesve potencial të këtij raporti i është dhënë mundësia për të bërë analiza dhe krahasime të ndryshme varësisht prej interesimeve dhe nevojave që kanë.

Rëndësia e këtij programi qëndron edhe në faktin se është krijuar një arkiv elektronike për të dhënat statistikore dhe treguesit për katër vite shkollore, e që mund të shërbejë si bazë e të dhënave për përcjelljen e trendëve të gjithmbarshme në arsimin kosovar si dhe krahasimin e tij me vendet e rajonit dhe më gjerë. Arkivimi elektronik i këtyre të dhënave vazhdimisht duhet të freskohet dhe plotësohet me të dhëna të reja të cilat do të shërbejnë e ndihmojnë zhvillimin e politikave arsimore dhe planifikimet në arsim.

1 Jovica Filipović, zyrtari i njësisë për komunitete

2 Në disa raste janë paraitur të dhënat statistikore të viteve shkollore 2002-2003 dhe 2003-2004

Prezantimi i të dhënave statistikore është bërë sipas shtrirjes vertikale dhe horizontale të sistemit të arsimit në Kosovë dhe treguesit arsimor janë organizuar sipas kategorive në vijim:

#### **Kategoria**

### **I. NXËNËS/FËMIJË**

#### **Treguesit:**

1. Numri i nxënësve sipas niveleve ;
2. Numri i nxënësve sipas gjinisë;
3. Numri i nxënësve sipas përkatësisë etnike;
4. Numri i nxënësve në arsimin special.
5. Suksesi i nxënësve;
6. Braktisja e shkollës nga nxënësit;
7. Realizimi i planit dhe vijueshmëria e nxënësve.

#### **Kategoria**

### **II. PERSONEL ARSIMOR**

#### **Treguesit:**

1. Numri i personelit arsimor;
2. Struktura e personelit arsimor;
3. Numri i mësimdhënësve sipas viteve shkollore, niveleve arsimore dhe gjinisë;
4. Struktura kualifikuese e mësimdhënësve.

#### **Kategoria**

### **III. SHKOLLA/OBJEKTE**

#### **Treguesit:**


1. Numri i shkollave sipas viteve shkollore;
2. Numri i shkollave sipas gjuhëve mësimore;
3. Numri i shkollave me tri apo katër ndërresa.



# I. NXËNËS

## 1. Numri i nxënësve sipas niveleve

Numri i nxënësve nga viti në vit është rritur dhe ka shënuar një ngritje ndërmjet 1,200 deri në 2,000 nxënës. Kjo shkallë e rritjes paraqet përqindje të vogël dhe plotësisht është në përputhje me standardet e vendeve apo shteteve që kanë rrjedhë normale të zhvillimit të tyre. Shtimi i numrit të nxënësve për 1,180 ose 0.27 % nga viti shkollor 2004/2005 në vitin shkollor 2005/2006 veç sa e vërteton konstatimin tonë të dhënë më lartë.



**Grafiku 1.** Rritja e numrit të nxënësve sipas viteve shkollore

Viti shkollor 2006/2007 shënon përmbylljen e implementimit të strukturës së re të arsimit 5-4-3/4. Në këtë vit shkollor, në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, mësimi ka filluar të zhvillohet edhe në klasën e 13-të në gjimnaz - drejtimi i përgjithshëm dhe në shumicën e drejtimeve dhe profileve të shkollave profesionale. Prandaj, realizimi i strukturës së re arsimore ka ndikuar që dallimi i numrit të nxënësve në krahasim me vitet tjera të jetë dukshëm më i madh gjë të cilën e vërteton e dhëna se rritja e numrit të nxënësve në vitin shkollor 2006/2007 krahasuar me atë paraprak 2005/2006 është 3.93 %. Mirëpo, hiç dallimin e klasës së 13-të, rritja e numrit të nxënësve ka pothuaj rrjedhë standarde që d.m.th. se përfshinë një rritje të vogël në shumicën e komunave të Kosovës në njërin anë dhe anën tjetër një rënie të vogël të numrit të nxënësve në disa komuna si në Deçan, Dragash, Novobërdë, Klinë, Shtërpçë, Therandë dhe Leposaviq .

**Tabela 1.** Numri i nxënësve sipas viteve shkollore, komunave dhe në nivel vendi

Komuna	2004/05	2005/06	2006/07
Deçan	10,367	10,078	10,249
Dragash	6,599	6,645	6,328
Ferizaj	6,287	6,426	6,870
F. Kosovë	27,878	28,375	29,825
Gjakovë	25,105	25,146	25,643
Gjilan	25,181	24,991	26,917
Glllogoc	15,292	15,413	15,683
Istog	9,730	10,170	10,454
Kaçanik	10,147	10,102	12,471
Kamenicë	8,012	8,137	8,300
Klinë	10,499	10,272	10,604
Leposaviq	18	19	18
Lipjan	13,448	14,022	14,769
Malishevë	19,045	16,817	17,283
Mitrovicë	17,898	18,262	18,938
Novobërdë	358	334	313
Obiliq	4,349	4,865	4,556
Pejë	22,275	22,413	23,586
Podujevë	21,729	21,743	22,724
Prishtinë	44,310	45,959	47,621
Prizren	38,272	38,416	39,911
Rahovec	15,311	14,898	15,058
Skenderaj	14,210	13,903	14,820
Suharekë	17,069	16,877	17,069
Shtërpcë	766	811	830
Shtime	7,086	7,214	7,526
Viti	12,919	13,016	13,211
Vushtrri	17,219	17,235	17,614
Z. Potok	206	204	192
Zveçan	54	56	62
Gjithsej	421,639	422,819	439,445

Marrë në tërësi hetohet një shtim normal nominal i numrit të nxënësve në të gjitha nivelet dhe vitet e shkollimit. Megjithatë në tri vitet e fundit rritja më e madhe e numrit të nxënësve vërehet te shkollat e mesme të larta. Për të ilustruar këtë po prezantojmë të dhënat statistikore për vitin shkollor 2006/2007 për të treguar raportin në përqindje gjimnaz – shkolla profesionale.

Në vitin shkollor 2006/2007 në shkollat e mesme të larta mësimin e kanë ndjekur gjithsej 88.691 nxënës. Në gjimnaze 36.889 përkatësisht 41.59% ndërsa në shkollat profesionale 51.802 apo 58.40%. Kjo d.m.th. se raporti përkatësisht dallimi gjimnaz – shkolla profesionale sillet rreth 40% me 60% (plus – minus 1 deri në 2 %).



**Tabela 2.** Numri i nxënësve sipas gjinisë , klasave dhe tipit të shkollave profesionale**Nxënësit ne shkollat profesionale 2006/07**

Nri shkollave	Tipi i shkollës	kl. 10			kl. 11			kl. 12			kl. 13			Gjithsej		
		m	f	gj	m	f	gj	m	f	gj	m	f	gj	m	f	gj
1	Artit (AM)	40	60	100	66	80	146	58	48	106	59	53	112	223	241	464
3	Bujqësore (AG)	678	404	1,082	533	337	870	468	341	809	192	96	288	1,871	1,178	3,049
10	Ekonomike (ECO)	1,979	1,345	3,324	1,964	1,452	3,416	1,760	1,279	3,039	1,137	1,025	2,162	6,840	5,101	11,941
7	M. mjekësisë (ME)	372	1,020	1,392	527	1,047	1,574	387	1,078	1,465	151	526	677	1,437	3,671	5,108
5	Muzikës (AM)	70	82	152	49	78	127	39	49	88	10	22	32	168	231	399
20	Teknike (TE)	5,281	1,887	7,168	4,813	1,781	6,594	3,958	1,404	5,362	2,724	1,315	4,039	16,776	6,387	23,163
1	Teologjike (TH)	99	75	174	118	61	179	108	66	174	99	42	141	424	244	668
1	Tregti (TR)	139	50	189	31	32	63	56	58	114	29	47	76	255	187	442
9	Mikste	1,533	605	2,138	1,220	542	1,762	1,211	573	1,784	573	311	884	4,537	2,031	6,568
57		10,191	5,528	15,719	9,321	5,410	14,731	8,045	4,896	12,941	4,974	3,437	8,411	32,531	19,271	51,802

## 2. Numri i nxënësve sipas gjinisë

Struktura gjinore në nivelin parashkollor përkatësisht parafillor dhe në atë fillor e të mesëm të ulët është pothuajse e njëjtë me strukturën e përgjithshme të popullsisë e cila përafërsisht sillet rreth 48% të gjinisë femërore me 52% të gjinisë mashkullore.

**Tabela 3.** Numri i fëmijëve sipas gjinisë në nivel vendi – Niveli parashkollor

Viti shkollor	Gjithsej nxënës	Gjinia femërore	%	Gjinia mashkullore	%
2004/2005	5,904	2,868	48.57	3,033	51.37
2005/2006	5,108	2,579	50.49	2,529	49.51
2006/2007	5,051	2,363	48.78	2,688	52.21

**Tabela 4.** Numri i fëmijëve sipas gjinisë në nivel vendi – Niveli parafillor

Viti shkollor	Gjithsej nxënës	Gjinia femërore	%	Gjinia mashkullore	%
2004/2005	17,596	8,384	47.60	9,216	52.40
2005/2006	20,750	9,961	48.00	10,789	52.00
2006/2007	21,089	10,203	48.38	10,886	51.61

Karakteristikë e veçantë e nivelit të arsimit parashkollor / parafillor, fillor dhe atij të mesëm të ulët është se ka rritje të vogël të përfshirjes së femrave në shkollim, mirëpo është brengosës fakti se kjo gjendje ndryshon në nivelin e arsimit të mesëm të lartë. Në të tri vitet shkollore në nivelin e arsimit të mesëm të lartë kemi rënien të përfshirjes së femrave, ku dallimi gjinor në këtë nivel të shkollimit është 14% përkatësisht rreth 43% të nxënësve janë të gjinisë femërore ndërsa 57% janë të gjinisë mashkullore.

**Tabela 5.** Numri i nxënësve sipas gjinisë në nivel vendi – Niveli fillor dhe i mesëm i ulët

Viti shkollor	Gjithsej nxënës	Gjinia femërore	%	Gjinia mashkullore	%
2004/2005	327,207	156,566	47.80	170,641	52.20
2005/2006	322,180	154,728	48.02	167,452	51.97
2006/2007	324,618	156,210	48.12	168,404	51.87

**Tabela 6.** Numri i nxënësve sipas gjinisë në nivel vendi – Niveli i mesëm i lartë

Viti shkollor	Gjithsej nxënës	Gjinia femërore	%	Gjinia mashkullore	%
2004/2005	60,760	30,820	44.20	38,940	55.80
2005/2006	74,781	32,202	43.00	42,579	57.00
2006/2007	88,691	38,581	43.50	50,110	56.50



Momentalisht nuk jemi në gjendje të japim pasqyrën gjinore të nxënësve sipas përkatësisë etnike, për shkak të mungesës së të dhënave, por konsiderohet e rëndësishme që në të ardhmen të punohet në mbledhjen e ketyre të dhënave dhe përpunimin e tyre.

### 3. Numri i nxënësve sipas përkatësisë etnike

Oscilimet e numrit të nxënësve sipas përkatësisë etnike, hiq ato të komunitetit serb në mungesë të të dhënave të sakta, nuk janë të mëdha. Të dhënat tregojnë një shtim fare simbolik të përfshirjes së nxënësve të komunitetit turk, atij ashkalinjë, egjiptian dhe kroatë dhe në anën tjetër kemi rënie të përfshirjes së fëmijëve/ nxënësve boshnjak, veçanërisht kur krahasohet viti shkollor 2004/2005 me atë 2006-2007. Oscilime ka edhe te komuniteti goran.

**Tabela 7.** Numri i nxënësve sipas përkatësisë etnike në nivel vendi

Përk. etnike	2004/2005	%	2005 /2006	%	2006/2007	%
Shqiptarë	408,360	96.85	409,257	96.79	425,999	96.94
Turq	2,951	0.69	3,009	0.71	3,053	0.69
Boshnjakë	5,234	1.24	4,291	1.01	4,504	1.02
Goranë	713	0.16	1,658	0.39	1,265	0.28
Ashkali	2,366	0.56	2,794	0.66	2,899	0.65
Romë	1,068	0.25	649	0.15	548	0.12
Egjiptianë	897	0.21	1,084	0.25	1,086	0.24
Kroatë	40	0.009	75	0.01	70	0.015
Të tjerë	10		2		21	
Total	421,639		422,819		439,445	



#### 4. Numri i nxënësve/ fëmijëve në arsimin special

Arsimi Special i referohet edukimit të posaçëm të tyre që kanë ngecje ose dëmtime në shqisa, dëmtime fizike, vështirësi në të nxënë, çrregullime sociale, emocionale dhe në komunikim dhe organizohet në shkolla speciale/ qendra burimore dhe shkolla të rregullta si klasë të bashkangjitur.

Arsimi special në Kosovë është i organizuar në kuadër të shkollave speciale, klasave të bashkangjitura si dhe në klasa të rregullta. Shtrirja gjeografike e shkollave speciale në Kosovë është joproportionale krahasuar me numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta sipas rajoneve dhe komunave. Shkolla të tilla kemi vetëm në pesë qendra komunale, në Prizren dhe Mitrovicë i kemi nga dy shkolla speciale ndërsa në Prishtinë, Pejë dhe Shtime nga një. Ndërsa në qendrat e mëdha komunale si Gjilan, Ferizaj, etj nuk kemi fare shkolla të tilla.

Të dhënat për përfshirjen e nxënësve në shkolla speciale janë kundërthënëse brenda dy viteve të fundit shkollore. Kjo vërtetohet ngase, në vitin shkollor 2005/2006 kemi një rënie të numrit të fëmijëve/nxënësve për 56, apo 5.95% në krahasim me vitin paraprak, ndërsa në vitin shkollor 2006/2007 kemi një rritje për 41 nxënës, përkatësisht 4.63%.

**Tabela 8.** Numri i nxënësve sipas grup-moshave dhe niveleve në shkolla speciale dhe klasë të bashkangjitura

Grup-moshat-klasat	2004/2005	2005/2006	2006/2007
3-4 vj.	21	10	7
4- >5 vj.	0	0	0
5- >6 vj..	30	14	14
I	183	101	88
II	178	138	101
III	154	172	120
IV	62	140	162
V	75	68	122
VI	51	63	62
VII	32	46	62
VIII	35	37	60
IX	42	37	38
X	36	22	23
XI	38	34	23
XII	3	2	43
Gjithsej	940	884	925

Gjendjen e tillë faktike të rënies së numrit të përfshirjes së fëmijëve në arsim special, veçanërisht në nivelin e mesëm të ulët dhe e nivelit të lartë, ndoshta, duhet kërkuar kryesisht te angazhimi i pamjaftueshëm i drejtuesve të shkollave për t'i tërhequr fëmijët në shkollë, programet mësimore joadekuate për nevojat e fëmijëve, mosinteresimi i familjes, hapja e klasave të bashkangjitura etj.



## Klasat e bashkangjitura

Klasat e bashkangjitura janë klasa që organizohen brenda shkollës së rregullt dhe qëllim parësor i tyre është përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në to dhe kalimi i tyre gradual (sipas arritjeve dhe performancës) në klasë të rregullta.

Klasat e para të bashkangjitura janë hapur në vitin shkollor 2002/2003, dhe gjeneratat e para tashmë janë në klasën e gjashtë. Mësimi në klasa të bashkangjitura është paraparë të organizohet në nivelin e parë dhe të dytë të shkollimit, përkatësisht në shkollimin fillor dhe atë të mesëm të ulët.

Klasat e bashkangjitura janë formuar në çdo shkollë ku ka patur interesim dhe kushte elementare për funksionimin e saj.

Njëra nga objektivat e Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2007-2017 është që të gjithë fëmijët me nevoja të veçanta të përfshihen në ndonjë formë arsimimi dhe edukimi. Në kuadër të reformimit të arsimit të Kosovës, ka disa vite që promovohet koncepti gjithëpërfshirës përmes hapjes së përkohshme të klasave të bashkangjitura në kuadër të shkollave të rregullta, krahas shndërrimit të shkollave speciale në qendra burimore.

**Tabela 9.** Numri i nxënësve sipas gjinisë në klasat e bashkangjitura

Vitet	Gjithsej	Femra	%	Meshkuj	%
2004/2005	434	157	36.17	277	63.82
2005/2006	514	193	37.54	321	62.45
2006/2007	456	167	36.62	289	63.37

Në vitin shkollor 2004/05 janë hapur 50 klasa të bashkangjitura, ky numër është rritur në 66 klasë gjatë vitit shkollor 2005/06 kurse në vitin 2006/07 kanë vepruar katër klasë më pak, përkatësisht të bashkangjitura, që po ashtu tregon trend të rënies së përfshirjes së fëmijëve, veçanërisht të femrave.

Nxënësit e klasave të bashkangjitura nëse arrijnë t'i zotërojnë standardet e përmbajtjes dhe të arritshmërisë së mësimi të rregullt atëherë ata kalojnë nga klasa e bashkangjitur në klasë të rregullt. Numri i nxënësve që kanë kaluar nga klasat e bashkangjitura në klasa të rregullta deri më tani supzohet të jetë simbolik, por nuk mund të vërtetohet përshkak se mungojnë të dhënat për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në mësimin e rregullt.

## 6. Sukses i nxënësve

Për të pasur një pasqyrë më të plotë, më të qartë, dhe sa më objektive të suksesit të nxënësve jemi mbështetur në:

- vlerësimin subjektiv, me notë, të mësimdhënësve në shkolla;
- testin e arritshmërisë pas përfundimit të nivelit të mesëm të ulët përkatësisht të klasës së nëntë;
- testin e maturës pas përfundimit të nivelit të mesëm të lartë përkatësisht të klasës së dymbëdhjetë/ trembëdhjetë.

Për të qenë krahasimi sa më i vlefshëm dhe më i qëndrueshëm në disa raste kemi shfrytëzuar tregues të suksesit të nxënësve edhe për vitet shkollore 2002/03 dhe 03/04.

### Suksesi sipas vlerësimit me notë


#### Viti shkollor 2003/2004

Suksesi i përgjithshëm pozitiv për të tri nivelet e shkollimit është 93.81% ndërsa vetëm 5.35% e nxënësve kanë sukses negativ. Ky sukses dallon edhe nga niveli në nivel. Në nivelin e parë dhe të dytë suksesi është dukshëm më i lartë se sa në nivelin e tretë. Në nivelin e parë dhe në nivelin e dytë (klasat 1 – 9) 96% e nxënësve kanë sukses pozitiv dhe vetëm 3.16% kanë sukses negativ, kurse në nivelin e tretë (klasat 10-13) 83.42% e nxënësve kanë sukses pozitiv ndërsa 16.58% kanë sukses negativ.


#### Viti shkollor 2004/2005

Dallimet e suksesit të nxënësve nuk janë vetëm sipas niveleve apo viteve shkollore por veçanërisht këto dallime janë të dukshme sidomos kur krahasohet gjysmëvjetori i parë me gjysmëvjetorin e dytë. Edhe pse suksesi pozitiv i nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2004/2005 është 12% më i ulët krahasuar me suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2003/2004 dhe i njëjti kur krahasohet me suksesin e nxënësve në fund të vitit shkollor 2003/2004 diferenca shkon në 20.39%. Kjo shkallë kaq e lartë e dallimeve është shumë brengosëse. Prandaj preokupim kryesor, jo vetëm i shkollave, drejtorive komunale, MASHT-it por edhe i ekspertëve mbetet aftësimi dhe ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve për mënyrat dhe format e vlerësimit të nxënësve.





**Grafiku 2.** Suksesi i nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2004/05



**Grafiku 3.** Suksesi i nxënësve në fund të vitit shkollor 2004/05

*Suksesi është i përgjithësuar dhe i përfshin të tri nivelet e shkollimit*

#### Viti shkollor 2005/2006

**Tabela 10.** Suksesi i nxënësve në arsimin parauniversitar sipas niveleve

Klasat	1-5	%	6-9	%	10-12	%	Gjithsej	%
Suksesi pozitiv	156,995	91.18	99,715	66.85	26,627	36.90%	283,337	73.20
Suksesi negativ	15,175	8.81	43,040	30.14	45,516	63.09%	103,731	26.79
Gjithsej të notuar	172,170	98.63	142,755	98.37	72,143	97.63%	387,068	98.35
Gjithsej të pa notuar	2,385	1.36	2,356	1.62	1,750	2.36%	6,491	1.64
Totali	174,555		145,111		73,893		393,559	

## Rezultatet e Testit të arritshmërisë pas përfundimit të klasës së 9-të

### Viti shkollor 2002/2003

Rezultati i përgjithshëm i testit të arritshmërisë për këtë vit shkollor është 53.08 %.

Rezultati në gjuhë dhe shkenca shoqërore tregon shkallë të arritshmërisë prej 56.08 % ndërsa, në matematikë dhe shkenca ka shkallën e arritshmërisë 50.09 %.

### Viti shkollor 2003/2004

Rezultati i përgjithshëm i testit të arritshmërisë, në këtë vit, është 54.04%. Edhe në këtë vit shkollor rezultati në gjuhë dhe shkenca shoqërore është më i mirë dhe tregon shkallë të arritshmërisë prej 56.03% ndërsa në matematikë dhe shkenca është më i ulët dhe ka shkallën e arritshmërisë 52.05%.

### Viti shkollor 2004/2005


Rezultati i përgjithshëm i testit të arritshmërisë, krahasuar me vitet paraprake, shënon rënie dhe është vetëm 45.03%. Rezultati në gjuhë dhe shkenca shoqërore tregon shkallë të arritshmërisë prej 46.06% ndërsa në matematikë dhe shkenca ka shkallën e arritshmërisë 44.00%. Dallimet në mes njërit dhe tjetrit test janë më të vogla vetëm 2.06%.

### Viti shkollor 2005/2006

Rezultati i përgjithshëm i testit të arritshmërisë është 45.08%. Në këtë vit shkollor ndodh një përmbysje e rezultatit ku në matematikë dhe shkenca shkalla e arritshmërisë është 43.55% ndërsa në gjuhë dhe shkenca shoqërore shkalla e arritshmërisë është 41.03%.

### Viti shkollor 2006/2007

Rezultati i përgjithshëm i testit të arritshmërisë është 46.07%. Dallimet mes testeve në këtë viti janë në favor të gjuhës amtare dhe shkencave shoqërore ku rezultati arrin 50.08% për dallim nga testi i arritshmërisë në matematikë dhe shkenca natyrore i cili është 42.07%.



**Grafiku 4.** Rezultatet Testit të arritshmërisë sipas viteve shkollore



Rezultatet e përgjithshme të testit të arritshmërisë gjatë këtyre viteve në shqyrtim, në vazhdimësi, tregojnë rënie që nga testi i dytë e këtej. Duhet të hulumtohen shkaqet e kësaj rënie. Rezultatet e Testit kombëtar të vitet shkollore 2002/03; 2003/04 dhe 2004/05 pasqyrojnë arritjet vetëm të nxënësve të klasëve të nënta të shkollave publike.

Ndërkaq në rezultatet e Testit Kombëtar të arritshmërisë në vitet shkollore 2005/06 dhe 2006/07 janë të përfshirë edhe nxënësit e shkollave private të cilat kanë arritur të përmbyllin ciklin e shkollimit të obliguar, përkatësisht klasën e nëntë.

## Rezultatet e provimit të maturës

### Viti shkollor 2005/2006

Provimi i maturës, për herë të parë, ka filluar të mbahet në vitin shkollor 2005/2006.

Suksesi i tërësishëm i arritshmërisë në të gjitha drejtimet e gjimnazit është 46.07%, ndërsa sipas drejtimeve kemi këtë shkallë të arritshmërisë:

- drejtimi i gjuhëve 49.05 %;
- drejtimi i shkencave shoqërore 39.00 %;
- drejtimi i shkencave të natyrës 45.00%;
- drejtimi matematikë – informatikë 51.07%.

### Viti shkollor 2006-2007

Suksesi i tërësishëm në gjimnaze është 46.7% ndërsa sipas drejtimeve kemi këtë shkallë të arritshmërisë:

- drejtimi i gjuhëve: 51.5%;
- drejtimi i shkencave shoqërore: 44.7%;
- drejtimi i shkencave të natyrës: 51.3%;
- drejtimi matematikë – informatikë: 61.6%;
- drejtimi i përgjithshëm: 56%.

Në Testin e Maturës në arsimin profesional që është organizuar për herë të parë në vitin shkollor 06/07, kanë marrë pjesë gjithsej 8,148 nxënës. Nga ky numër sukses pozitiv kanë treguar 4,042 nxënës ose 49.6 %. Në gjuhën turke kanë marrë pjesë gjithsej 152 nxënës. Sukses pozitiv kanë treguar 130 nxënës ose 85.5%. Në gjuhën boshnjake kanë marrë pjesë gjithsej 170 nxënës. Sukses pozitiv kanë treguar 165 nxënës ose 97.1%.

## 6. Braktisja e shkollës nga nxënësit

Çështja e braktisjes së shkollës nga nxënësit është shqyrtuar dhe diskutuar shumë shpesh nga organizata qeveritare dhe joqeveritare, si vendore ashtu edhe ndërkombëtare. Për të bërë analizën e mirëfilltë të dukurisë së braktisjes së shkollës nga nxënësit do të duhej që të përcillet e njëjta gjeneratë e nxënësve nëpër çdo nivel shkollimi.

Në këtë tekst dukuria e braktisjes së shkollës nga nxënësit është shtruar nga dy këndvështrime:

a) Nga trendi i vijueshmërisë së nxënësve brenda tri viteve shkollore në tri nivelet:

Niveli I – klasat 1 – 3;

Niveli II - klasat 7 – 9


Niveli III- klasat 10 – 12.

b) Nga vijueshmëria e nxënësve në nivel shkolle, brenda vitit shkollor, që nënkupton se sa nxënës janë regjistruar në fillim të vitit dhe sa kanë qenë në fund të të njëjtit vit shkollor.

a) Nga trendi i vijueshmërisë së nxënësve brenda tri viteve shkollore në tri nivelet:

**Tabela 11.** Vijueshmëria e nxënësve sipas viteve dhe niveleve shkollore

Vitet	kl.1	kl.2	kl.3	kl.7	Kl.8	kl.9	Kl.10	Kl.11	kl.12
2004/05	36,129			33,364			27,111		
2005/06		34,012			32,818			25,144	
2006/07			33,840			32,058			23,377



**Grafiku 5.** Vijueshmëria e nxënësve sipas niveleve dhe viteve shkollore

Në nivelin fillor braktisja e shkollës nga nxënësit e regjistruar në klasë të parë, krahasuar si gjenëratë, në klasën e dytë është relativisht i lartë, 5.85%, ndërsa prej të dytës në të tretën kjo braktisje është shumë më e vogël, vetëm 0.5%. Me fjalë të tjera, nga numri i i nxënësve të regjistruar në klasën e parë, në vitin shkollor 04/05, 93.67% sosh vazhdojnë shkollimin e mëtutjeshëm në këtë nivel.



**Tabela 12.** Vijueshmëria e nxënësve sipas viteve arsimit fillor

Vitet	klasa. 1			klasa. 2			klasa. 3			%		
	T	F	M	T	F	M	T	F	M	T	F	M
2004/05	36,129	17,109	19,020									
2005/06				34,012	16,381	17,631						
2006/07							33,840	16,192	17,648	93.66%	94.64%	92.79%
										6.34%	5.36%	7.21%

Në nivelin e mesëm të ulët braktisja e shkollës nga nxënësit që kanë ndjekur mësimin në klasën e shtatë krahasuar me të njëjtit në klasën e tetë është 1.63% ndërsa kjo braktisje nga klasa e tetë në të nëntën shënon rritje në 2.31%. Me fjalë të tjera, nga numri i nxënësve të regjistruar në klasën e shtatë, në vitin shkollor 04/05, 96.09% sosh vazhdojnë shkollimin e mëtutjeshëm në këtë nivel.

**Tabela 13.** Vijueshmëria e nxënësve sipas viteve arsimit fillor mesëm i ulët

Vitet	klasa. 7			klasa. 8			klasa. 9			%		
	T	F	M	T	F	M	T	F	M	T	F	M
2004/05	33,364	16,003	17,361									
2005/06				32,818	15,747	17,071						
2006/07							32,058	15,423	16,635	96.09%	96.38%	95.82%
										3.91%	3.62%	4.18%

Në nivelin e mesëm të lartë braktisja e shkollës nga nxënësit që kanë ndjekur mësimin në klasën e dhjetë krahasuar me të njëjtit në klasën e njëmbëdhjetë është 7.25%, ndërsa braktisja nga klasa e njëmbëdhjetë në të dymbëdhjetën është 7.02%. Me fjalë të tjera, nga numri i nxënësve të regjistruar në klasën e dhjetë, në vitin shkollor 04/05, 86.2% sosh vazhdojnë shkollimin e mëtutjeshëm në këtë nivel.



**Tabela 14.** Vijueshmëria e nxënësve sipas viteve arsimit mesëm të lartë

Vitet	klasa. 10			klasa. 11			klasa. 12			%		
	T	F	M	T	F	M	T	F	M	T	F	M
2004/05	27,111											
		11,403	15,708									
2005/06				25,144	11,002	14,142						
							23,377	10,349	13,028	86.23%	90.76%	82.94%
2006/07										13.77%	9.24%	17.06%

Nga kjo vijmë në përfundim se niveli i braktisjes së shkollës nga nxënësit e gjeneratës klasat 1-3 është 6,33 %, nga nxënësit e gjeneratës - klasat 7-9 është 3.9%, kurse nga ata të gjeneratës së klasave 10-12 është 13.77 %. Këto të dhëna, për braktisjen e shkollës, janë tepër shqetësuese sidomos në nivelin e arsimit të lartë. Po ashtu shqetësuese është edhe braktisja e shkollës nga nxënësit e nivelit fillor dhe atij të mesëm të ulët. Shiqur nga aspekti gjinor dukuria e braktisjes është e shprehur më shumë te meshkujt në nivelin e parë (1-5) dhe të tretë (10-12), ndërsa në nivelin e dytë (6-9) përqindja e braktisjes është përafërsisht e njëjtë për të dy gjinitë.

#### b) Vijueshmëria e nxënësve në nivel shkolle, brenda një vitit shkollor

Mënyra tjetër e paraqitjes së të dhënave, për braktisjen e shkollës nga nxënësit bazohet në informacionet dhe të dhënat në nivel shkolle brenda një vitit shkollor. Kjo mënyrë e paraqitjes jep mundësinë e krahasimeve të braktisjes mes viteve shkollore dhe më qartë shihen trendët e kësaj lëvizjeje.


Në vitin shkollor 2002/2003 braktisja e shkollës nga nxënësit në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët (klasat 1 – 9) shënon shkallën prej 1.63%. Raporti gjinor i braktisjes në këtë nivel është 1.70% meshkuj dhe 1.63% femra. Në nivelin e mesëm të lartë (klasat 10 – 12) braktisja shënon shkallën prej 2.00%. Raporti gjinor i braktisjes në këtë nivel është: 2.56% meshkuj ndërsa femra 2.00%.

Në vitin shkollor 2003/2004 braktisja e shkollës nga nxënësit në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët (klasat 1 – 9) shënon shkallën prej 1.61 %. Raporti gjinor i braktisjes në këtë nivel është 1.44 % meshkuj dhe 1.79 % femra. Në nivelin e mesëm të lartë (klasat 10 – 12) braktisja shënon shkallën prej 3.56 %. Raporti gjinor i braktisjes në këtë nivel është 4.17 % meshkuj, ndërsa femra 2.81%.

Në vitin shkollor 2004/2005 braktisja e shkollës nga nxënësit në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët (klasat 1 – 9) shënon shkallën prej 1.71 %. Raporti gjinor i braktisjes në këtë nivel është 1.40 % meshkuj dhe 1.30 % femra. Në nivelin e mesëm të lartë (klasat 10 – 12) braktisja shënon shkallën prej 2.07 %. Raporti gjinor i braktisjes në këtë nivel është 2.56 % meshkuj ndërsa femra 1.46%.



